

PLANI STRATEGJIK 2022—26

FUSHAT E FOKUSIT STRATEGJIK

Objektivat strategjike gjatë periudhës së Planit Strategjik 2022-2026 përfshijnë: (1) Forcimi i mbledhjes së të hyrave dhe zvogëlimi i hendekut tatimor—maksimizimi i të hyrave të mbledhura dhe të pagueshme sipas ligjeve të të hyrave të Kosovës (2) Modernizimi i Administratës Tatimore—zbatimi i një sistemi të ri të administrimit të teknologjisë së informacionit, modernizimi i strukturave tona organizative, dhe (3) ngritja e kapaciteteve të stafit dhe kapaciteteve institucionale për t'iu përgjigjur mjedisit tonë të ri.

TË FORCOHET MBLEDHJA E TË HYRAVE DHE TË ZVOGËLOHET HENDEKU TATIMOR

- Të rriten mbledhjet e të hyrave me zgjerimin e aktivitetit ekonomik pas COVID-19 duke trajtuar evazionin fiskal në mbështetje të objektivave fiskale të Qeverisë.
- Të avancohet zhvillimi i metodologjisë dhe teknikave për matjen e hendekut tatimor për ta kuptuar më mirë shkallën e mospërbushjes.
- Të përcaktohen strategjitë prioritare të përmbushjes për të adresuar humbjen e të hyrave dhe për të ulur hendekun tatimor, përfshirë adresimin e abuzimeve tatimore në ekonominë joformale dhe përmirësimin e përmbushjes së TVSh.

TË SIGUROHEN SISTEME, PROCESE DHE MJETE BASHKËKOHORE TË TI-SË

- Të finalizohet zhvillimi dhe aplikimi progresiv i sistemit të ri të teknologjisë së informacionit në administratën tatimore në përputhje me planin e zbatimit.
- Të rikonfigurohen detajet në sistemin e ri, të kryhet korrigjimi i defekteve dhe të metave të identifikuar dhe të bëhet mirëmbajtja dhe modifikimi i sistemit gjatë periudhës së garancisë.
- Të sigurohet se operatori ekonomik e zhvillon një program të aftësimin për të mbështetur stafin me teknologji të re dhe procese të ndryshuara të punës para zbatimit të sistemit të ri
- Të zhvillohen shërbime dhe ndërveprime digjitale (online) për ta lehtësuar përmbushjen për tatimpaguesit.

TË PËRMIRËSOHET PËRMBUSHJA E TATIMPAGUESVE TË MËDHENJ

- Sigurimi i menaxhimit efektiv të përmbushjes së atyre tatimpaguesve që përbëjnë pjesën më të madhe të të hyrave tatimore.
- Të zgjerohen kriteret për përcaktimin e numrit të tatimpaguesve të administruar nga Departamenti i Tatimpaguesve të Mëdhenj (DTM) për të përfshirë tatimpagues me rëndësi strategjike.
- Të zhvillohet një kapacitet specifik i menaxhimit të rrezikut në DTM duke përfshirë krijimin e filtrave specifikë të rrezikut, me indikatorë specifikë financiar dhe tatimor, për bizneset e mëdha.
- Të sigurohet mbështetje e vazhdueshme nga partnerët/donorët zhvillimor për të ndërtuar kapacitetet e transferimit të çmimeve.
- Të rritet numri i stafit të kontrollit përmes rekrutimit të jashtëm të targetuar dhe të adresohen nevojat për aftësim dhe zhvillim në DTM, përfshirë ngritjen e shkathtësive teknike dhe kapaciteti i kontrollit.

MIRATIMI I PRAKTIKAVE NDRËKOMBËTARE PËR PROCESET THELBËSORE

- Të ridizajnohen proceset themelore të punës në linjë me zhvillimet në administratat lidere tatimore, për ta rritur efektivitetin tonë. Kontrollat të zbatohen Strategjia për Përmirësimin e Kontrollave 2020-2022 për t'i modernizuar proceset, teknikat dhe shkathtësitë e kontrolleve.
- Mbledhja e detyrueshme
- Të aplikohen procese të reja të punës së mbledhjes së detyrueshme; të zbatohen strategji të mbledhjes për të siguruar se borxhet e reja kapen e kthehen në kohë dhe për të reduktuar stokun e madh të borxhit.
- Të përmirësohet vazhdimisht praktika e mbledhjes së borxheve duke i marrë parasysh zhvillimet në administratat e tjera tatimore.

FORCIMI I REGJISTRIMIT, DEKLARIMIT, RAPORTIMIT TË SAKTË DHE PAGESAVE

- Të zgjerohet procesi për identifikimin, vlerësimin, priorizimin dhe zbutjen e rreziqeve të përmbushjes për t'i mbuluar rreziqet e rëndësishme për të gjitha llojet e tatimeve dhe për të siguruar që tatimpaguesit përmbushin detyrimet e tyre dhe (1) regjistrohen saktë në sistemin tatimor; (2) dorëzojnë deklaratat tatimore në kohë; (3) raportojnë plotësisht dhe saktë detyrimet e tyre tatimore; dhe (4) paguajnë detyrimet në kohë.
- Të ndërtohet kapaciteti i analizës së të dhënave dhe analitikës për të mbështetur identifikimin e rrezikut të përmbushjes duke identifikuar mosdeklaruesit dhe të hyrat e nënraportuara.
- Të rritet qasja dhe përdorimi i të dhënave të palëve të treta nga institucione të tjera për të forcuar identifikimin e rrezikut të përmbushjes.
- Të vazhdohet me përmirësimin e integritetit të bazës së të dhënave të regjistrimit të tatimpaguesve duke i hequr tatimpaguesit joaktivë, shënimet e dyfishta, si dhe llogaritë e pasakta.

TË MIRATOHET STRUKTURA ORGANIZATIVE BASHKËKOHORE DHE TË OPTIMIZOHET

- Të zhvillohen opsionet për të përmirësuar dhe modernizuar më tej rrjetin e zyrave rajonale për t'i reflektuar praktikat moderne të administratës tatimore.
- Të hartohet një plan afatmesëm zbatimi pas shqyrtimit të përfitimeve të opsioneve të ndryshme të planit organizativ.
- Të diskutohet me Qeverinë çështja e ndryshimeve në pengesat ligjore për sa i përket rregullave për shërbimin civil, për të mundësuar zbatim të reformave organizative.
- Të rialokohen zyrtarët që lirohen pas automatizimit e përmirësimeve në strukturën organizative dhe ndryshimet në praktikat e punës për t'i adresuar prioritetet e ATK dhe rreziqet e reja.

MISIONI I ATK—SË:

Të mbledhim tatimet dhe të kontribuojmë në mbështetje të interesit publik dhe mirëqenies së qytetarëve të Kosovës

TË SIGUROHEN SHËRBI ME BASHKËKOHORE PËR TATIMPAGESIT

- Forcimi i regjistrimit, deklarimit, raportimit të saktë dhe pagesave
- Të zhvillohen shërbime elektronike në internet dhe mjete interaktive për t'i mundësuar tatimpaguesit që t'i realizojnë transaksionet në internet dhe të ulin edhe më shumë nevojën për kontakt sy më sy.
- Të vazhdohet me përmirësimin e udhëzimeve dhe këshillave për detyrimin për regjistrim, deklarim dhe pagesë për të gjitha llojet e tatimeve përmes përmirësimeve në ueb faqe të ATK, broshurave dhe fletëpalosjeve informuese, vendimeve tatimore, vizitave te bizneset dhe programeve të informimit direkt, seminareve dhe punëtorive online, përdorimit të mediave tradicionale dhe mediave sociale; si dhe thirrjeve tek bizneset e reja dhe atyre që punësojnë për herë të parë.
- Publikimi i Kartës së Tatimpaguesve që përcakton të drejtat dhe përgjegjësitë e tatimpaguesve gjatë bashkëveprimit të tyre me ATK, për të forcuar besimin dhe respektin reciprok.

TË RRIETEN KAPACITETET DHE SHKATHTËSITË E STAFIT TONË

- Të identifikohen kërkesat tona të ardhshme për fuqi punëtore (numri i stafit dhe zotësit kryesore) për t'i përmbushur objektivat tona strategjike duke marrë parasysh teknologjitë e reja dhe reformat; të hartohet një plan për t'i adresuar mungesat e aftësive organizative.
- Të hartohen programe afatshkurtra dhe afatmesme të zhvillimit të shkathtësive dhe rekrutimit për t'i adresuar fushat prioritare duke përfshirë teknologjinë e informacionit, analizën e të dhënave, shkathtësitë e kontrollit, lidhshmërinë dhe aftësitë menaxheriale.

VLERAT

PROFESIONALIZMI DHE PËRGJEGJSHMËRIA PERSONALE

Të përkushtuar ndaj standardeve më të larta të arritjes

VIZIONI I ATK—SË:

Të jemi të besueshëm dhe të respektuar, si dhe të jemi mirë të krahasueshëm me administratat udhëheqëse tatimore në Europë.

TË FORCOHET KORNIZA MENAXHUESE NË ATK

- Të monitorohet progresi i Planit Strategjik për të siguruar që reformat sjellin rezultatet e pritura.
- Të miratohet një proces i menaxhimit të projekteve për monitorimin e progresit me reformat kryesore
- Të zhvillohet një proces për identifikimin e rreziqeve institucionale, për të minimizuar ndikimin në rezultatet e ATK
- Të forcohen lidhjet me administratat e tjera tatimore për zhvillimin e kapaciteteve dhe mundësitë e trajnimit.
- Të punohet ngushtë me partnerët zhvillimorë dhe të sigurohet pjesëmarrje në Programin e BE- së Fiscalis për zhvillimin e kapaciteteve dhe mbështetje të trajnimeve.
- Të mbështetet programi legjislativ vjetor i qeverisë përmes përfshirjes në grupet punuese
- Të rekomandohen ndryshime në ligjet ekzistuese tatimore
- Të punohet me MF-në për shkëmbimin automatik të informacionit dhe hapat për përparimin e masave nga Projekti i Erozionit Bazë dhe Zhvendosjes së Fitimit (BEPS).

TË FORCOHEN KONTROLLET E BRENDSHME, PROFESIONALIZMI DHE INTEGRITETI

- Të zbatohet në tërësi Plani i Përmirësimit të Integritetit 2021-2023 për të arritur nivele të larta të integritetit dhe profesionalizmit.
- Të miratohet strategji të tjera për t'i zbutur rreziqet e integritetit, duke përfshirë forcimin e Kodit të Etikës dhe të Mirësjelljes, si dhe procedurat në lidhje me parandalimin e konfliktit të interesit.
- Të forcohet integriteti duke zbatuar standarde dhe procedura dhe përmes trajnimeve dhe seminareve të rregullta në mënyrë që të mishërohet në të gjitha veprimet e zyrtarëve të ATK-së, duke promovuar transparencë dhe përsosmëri në shërbim.

RESPEKTI

baza për marrëdhëniet tona me punonjësit, kolegët dhe taksapaguesit

TRANSPARENCA

Të hapur për tatimpaguesit dhe palët e interesuara



NGA DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Plani strategjik 2022-2026 ofron drejtim dhe fokus të qartë të prioritetëve tona gjatë 5 viteve të ardhshme. Plani është hartuar për të ndihmuar ATK-në që të përmbushë vizionin e saj për të qenë e besueshme dhe e respektuar si dhe e krahasueshme me administratat lidere tatimore në Evropë. Ai përcakton se si do t'i përgjigjemi kërkesave të ndryshme për administratën tonë dhe paraqet strategjitë, prioritetet dhe aktivitetet në të cilat do të fokusohemi për t'i realizuar qëllimet dhe misionin tonë.

Plani vë theksin në tri qëllimet tona strategjike, për të siguruar që realizohen përmirësime të qëndrueshme në mbledhjen e të hyrave, për përmbushjen e objektivave fiskale të Qeverisë, për modernizimin e administratës tatimore, si dhe për të siguruar që ATK të ketë kapacitetet dhe ekspertizën e duhur të stafit për t'iu përgjigjur ndërlidhshmërisë së administratave moderne tatimore. Gjatë periudhës së planit, do të avancojmë një sërë nismash reformuese për të ndërtuar një administratë tatimore moderne dhe efektive. Këto nisma do ta udhëzojnë hartimin e strategjive dhe veprimeve specifike në planet tona vjetore operative dhe strategjike.

Pjesë integrale e realizimit të planit tonë është kontributi i stafit tonë. Jam krenar për profesionalizmin dhe përkushtimin e tyre dhe mirëpres udhëtimin tonë të përbashkët dhe mbështetjen tonë për ndërtimin e vendit dhe rritjen ekonomike për të mirën e të gjithë popullit të Kosovës.

INTEGRITETI DHE NDRËSHMËRIA

Trajtim i drejtë i njerëzve dhe zbatim i drejtë i ligjit

FLEKSIBILITETI

Përshtatemi dhe reagojmë me shpejtësi në mjedis të jashtëm